



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Rektor

Prof. Dr. Marjan DEMA

Nr. Prot.: 3/425

Datë: 17/11/2017


Senati i Universitetit të Prishtinës referuar në marrëveshjen nr. 189/01B të datës 13.5.2015, në mbledhjen e XXX-të të mbajtur më datën 31.10.2017, mori

V E N D I M

- I. Studentët e degëve të Fakultetit të Edukimit, Fakultetit Juridik dhe Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Prishtinës, qendra në Gjilan, të regjistruar deri në vitin akademik 2012/13 (përfshirë vitin 2012/13), nga viti akademik 2017/18 do të transferohen me të gjitha të drejtat, detyrimet në kuadër të fakulteteve përkatëse në Prishtinë.
- II. Studentët e degëve të Fakultetit të Edukimit, Fakultetit Juridik dhe Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Prishtinës, qendra në Gjilan, të cilët dëshirojnë të transferohen në fakultetet përkatëse në kuadër të Universitetit Kadri Zeka në Gjilan (UKZ), duhet të bëjnë kërkesë pranë fakulteteve gjegjëse në UKZ-Gjilan.
- III. Studentëve të transferuar nga UP në UKZ, në përputhje me marrëveshjen nr. 189/01B të datës 13.5.2015, UKZ do t'i siguroj kushtet akademike dhe infrastrukurore deri në diplomimin e tyre.
- IV. Studentët si në pikën III të këtij vendimi, pas diplomimit do të pajisen me diplomë të UKZ-Gjilan.
- V. Administrata e fakulteteve përkatëse e UP-së dhe UKZ-së, do të bëjnë transferin e dosjeve të kandidatëve të transferuar në kuadër të fakulteteve përkatëse të UP-së në Prishtinë.
- VI. Shërbimi i teknologjisë informative i fakulteteve përkatëse të UP-së në Prishtinë, obligohet që menjëherë të filloi futjen/migrimin e të dhënave në SEMS për të gjithë studentët e transferuar nga dega e Gjilanit në UP-Prishtinë.
- VII. Studentëve të transferuar si në pikën I të këtij vendimi, duke filluar nga afati i plotësues nëntorit, do t'iu mundësohet paraqitja dhe hyrja në provimet e mbetura, në kuadër të fakultetit përkatës në Prishtinë.
- VIII. Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit në Senat.

Vendimi t'i dërgohet:

1. Arkivit të UP-së;
2. Dekanëve të njësive akademike të UP-së dhe UKZ-së;
3. Sekretarëve të njësive akademike të UP-së;
4. Sekretarit të përgjithshëm të UP-së dhe UKZ-së;
5. Për publikim në ueb-faqe.



Prof. dr. Marjan Dema

Kryesues i Senatit të UP-së